



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

ZYRA E PROKURIMIT

01 NR 352-8885/19

Me 04.03.2019

KONTRATA , KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I: KONTRATA KORNIZE NR. 05/2019

KOMUNA KLINE (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), NR. Bisnesit, 0700032, Nr Fiskal 600219366 **qe perfaqesohet nga Menaxheri z. Abaz Foniqi**
në një të anë; dhe

"N.T.P." AGONITI " (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), PRISHTINE . me numer bisnesi **70663600 dhe numer fiskla 600667862** me pronar z. MISIM BEQIRI .Ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

FURNIZIM ME DRU PER NGROHJE PER NEVOJA TE NJESIVE KERKUESE TE KOMUNE SE KLINES

me numër Identifikues 634-18-6622-121/NR. INTRN 634-18-083-121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **kontrate publike KORNIZE**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me *me te neshkruar perkatesisht me daten 04.03.2019 DERI me 03.03. 2022*

1.3 Afati kohor i performances *36 muaj* nga data e marrjes së urdhërësës NGA Perfaqesuesi i Autorizuar .-Perkateshist mengjeri i kontrates .

1.4. Sherbimi I FURNIZIMIT SIPAS FLETEPOROSIVE ME URDHERBLERJE -

1.4 Vendi i **kryerjes së FURNIZIMEVE** do të jetë *Kline* .

Pikat e shperdarjes ne Institucionet e komunes Kline,

- " Kline shkollat ne Qytet dhe fshatra ,
- QKMF 'Nene Tereza " Kline dhe Lokalitetet e Klines,
- Zyret e Ofiqarive ne Terren, dhe
- SHBZ ,

sipas Nevojave dhe Kerkesave te Njesive kerkuese.

FURNIZIMET DO TE BEHEN NE VENDIN E CAKTUAR NGA MENAXHERI I KONTRATES

1.5. Furnizimet duhet te jene te Cilesise se dhene ne Oferten Finaciare dhe Parametrat e dhene ne Oferte ..

Furnizim me dru per ngrohje

-Dru duhet te jene te cilesise se larte Bung apo qarr -Me transport , Me sharritje.

- Drute duhet maten ne tok para se te pranohen nga organi mbikqyres,

Drute duhet te jene te lejuara per shitje nga APK – Pergjegjesi per kete bie mbi O.E .
qe furnizhon me dru Autoriteitin kontraktues Komuna e Klines .

Produktet duhet te distribuohen ne Kline sipas kerkesave jo me shume se 5 dite nga
kerkesa e dorzuar me fleteporosi dhe Urdherporosi

1.6. Incotermi i aplikueshem do te jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshem

2.1 Ligji i zbatueshem do te jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

NR. I AR	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJ ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	DRU PER NGROHJE	M/HAPSINOR	3000	39.20	117.600.00

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Gjithsejtë DDP – Me te gjitha taksat e aplikueshme 117.600.00€
(nënetedhjetenentemijeteteqindeuro)

3.2. Sasia e eshte e planifikuar .Me kekses te njesisve kerkuese mund te porositet (+) (-) 30 % e sasise se planifikuar , gjate Validitetit te Kontrates.

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e pagesës pas pranimit të tërë dërgesës- per furnizimet e kryera me Flete –pranim nga udheheqesi i marrjes se furnizimeve dhe fature

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

6.2. Kryesi i furnizimeve do te jete pergjegjes per Demtimet te shkaktuara me dashje apo pa kujdesi ne masen e demit qe do te percaktohet nga zyrtari pergjegjes .

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Ne raste deshtimit apo voneses ne Implementim , Do te penalizohet me masen 0.25% ne dite voneses nga vlere totale e kontrates.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, dhe të shikoj furnizimet e bera nëse është në masën e cilesive të kërkuara .

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqip** ² në katër origjinale, katër origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Neni 13. Menagjimi i Kontrates.

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

13.1. Menaxhimi i Kontrate conform Nenit 81 te LPP 05/L-068 do te behet nga Drejtoria :
DKA – SIPAS FUNKSIONIT DREJTORI Z. ARBEN LIMANAJ

**Operatorin Ekonomik
NTP "AGONITI" "PRISHTINE"**

**Për Autoritetin Kontraktues
Komuna Kline**

Emri:	MISIM BEQIRI	Emri:	Abaz Foniqi
Pozita:	DREJTOR	Pozita:	Zyrtar pergjegjes i Prokurimit
Nënshkrimi:	M. Beqiri	Nënshkrimi:	[Signature]
Data:	04.03.2019	Data:	04.03.2019
Vula:		Vula:	



PJESA IV E KONTRATËS:

MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT

[Me logon e institucionit financiar që e jep sigurinë]

Për: KOMUNA KLINE

(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: AGONITI – PRISHTINE

(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: FURNIZIM ME DRU PER NGROHJE

Numri i Prokurimit: 634-18-6622-121/ INTERN 634-18-083-121

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **11.760.00 €** (zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
 - b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.
- 9.980.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me: 36+1 = 37 MUAJ

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i institucionit financiar

Adresa



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta kenë

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. 72304

Për Komuna e Klina

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të N.T.P. AGONITI

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Furnizim me dru për ngrohje për nevoja të njësive kerkuese të komune të Klina

Nr. prokurimit: 634-18-6622-121 , Nr. brendshëm: 634-18-083-121

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **11,760.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **11,760.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë deri më 04.04.2022 ora 11:47:32

Per
Data lëshimit: 04.03.2019

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

[Signature]

